



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e dat. 30.04.2003 merr:

V E N D I M
PËR VAZHDIMIN E PAGAVE PUNËTORËVE TË DREJTORISË
PËR TOKË NDËRTIMORE NË PRISHTINË

I

Lejohet vazhdimi i pagave të punëtorëve të Drejtorisë për Tokë Ndërtimore në Prishtinë, në proporcion me nivelin e të ardhurave të punëtorëve në Kuvendin Komunal.

II

Vazhdimi i pagave për punëtorët sipas pikes I. të këtij Vendimi bëhet për periudhën prill - shtator 2003, ndërsa gjatë kësaj kohe duhet të definohet statusi i tyre.

III

Për realizimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtorati për Financa dhe Pronë.

IV

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.120-670 Data 08.05.2003

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri